

KOSOVA JONË



VENDOS

UDHËHEQJE E POPULLIT

ARGJEND (12), ESAT (11), GENT (12), GRANIT (11), LIRANDA (12), VALERA (11)

Nëse nuk keni dëgjuar për demokracinë, ju lutemi lexojeni këtë artikull. Ne nxënësit e klasës VI-1 përgatitëm këto informata për ju. Shpresojmë që do t'iu pëlqejnë

Sot në Punëtorinë e Demokracisë, kemi mësuar pikërisht për demokracinë. A dëshironi të dini edhe ju se çfarë kemi mësuar ne? Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke, „demos“ që do të thotë popull, kurse „kratia“ që do të thotë qeverisje. Nga kjo kuptojmë se demokracia është qeverisje e popullit. Qytetarët janë ata të cilët vendosin për të ardhmen e vendit të tyre. Ky sistem ka lindur në Greqi, sepse personat të cilët përdorën për herë të parë këtë formë të qeverisjes ishin grekët. Në vitin 507 p.e.s. në kryeqytetin e Greqisë, Athinë kishte demokraci direkte. Aty mbledheshin burrat e pasur. Mirëpo, nuk kishin të drejtë të merrnin pjesë gratë, të varfërit, por as të moshuarit. Në demokracinë e tashme, kanë të drejtë të gjithë të marrin pjesë në votim, por vetëm mbi moshën 18 vjeçare.

Ata votojnë kandidatët për deputetë, mandati i të cilëve zgjat për 4 vjet. Nëse nuk na pëlqen puna e ndonjë deputeti, në zgjedhjet e ardhshme ne do të votojmë dikë tjetër. Detyra e deputetit është të plotësojë kërkesat e qytetarëve. Në shkollë, kur kemi orë sportive, ne nxënësit votojmë për të zgjedhur kryetarin apo kapitenin e ekipit. Ai punon për grupin e tij. Kapiteni ka përgjegjësi ta udhëheq grupin për vetëm një mandat të caktuar. Ky mandat zgjat një orë. Kur vie ora tjetër, zgjedhim një kapiten tjetër. Ne dëshirojmë që të jemi të barabartë dhe të gjithë të kemi mundësi të njëjta që të bëhemi kapiten dhe të udhëheqim ekipin. Kjo është demokracia për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe ne jemi të lumtur që jetojmë në demokraci.



Kjo është forma e parë dhe më e vjetër e demokracisë



Vota është e rëndësishme në demokracinë përfaqësuese



Grupi i tretë në Punëtori



Qytetarët kanë të drejtë të pyesin deputetët e zgjedhur

ZGJEDHJET DHE RËNDËSIA E TYRE

AGNESA (11), ELSA (11), DIJONITA (14), LEONIT (12), ARTIS (11), ANDI (11), LABINOT (11)

„Pse është e rëndësishme të marrin pjesë qytetarët në procesin zgjedhor?“ Ishte kjo pyetja jonë, që ia parashtruar qytetarëve, gjatë intervistës me ta. Mësojeni se cilat ishin përgjigjet e tyre

Sot ishte një ditë e veçantë për ne. Përjetuam ndjenjën e të qenurit gazetarë. Grupi ynë, temë diskutimi kishte zgjedhjet. Prandaj, ne vendosëm të dalim jashtë dhe të bëjmë një intervistë me qytetarët. Të gjitha përgjigjet që i morëm nga të intervistuarit, vetëm sa i vërtetuan ato çka i diskutuam në grup. Vërtetuan se vlera e votës është jashtëzakonisht e madhe. Vota është e drejtë e të gjithë qytetarëve që jetojmë në demokraci. Prandaj, duhet të ndjehemi me fat dhe falenderues, që jetojmë një vend demokratik. Neve na mundësohet që vetë të zgjedhim përfaqësuesit tanë. Pra, mos lejoni që e drejta juaj për votë të mos shfrytëzohet. Sidomos tani, që jemi në prag të procesit zgjedhor.

Ne si qytetarë të Kosovës, duhet të mendojmë mirë para se të marrim hapin për t'ia besuar votën dikujt. Për këtë arsye, procesi zgjedhor është procesi më i rëndësishëm që ndodh në vendet demokratike. Në këtë proces ne si popull, zgjedhim rrugën drejt suksesit për vendin tonë. Dy llojet e zgjedhjeve në Kosovë janë: zgjedhjet parlamentare, ku i zgjedhim deputetët, si dhe zgjedhjet komunale, ku i zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse.

Të gjithë ne bëjmë zgjedhje. Për shembull, zgjedhim ekipin e futbollit që na pëlqen më shumë. Mirëpo, kjo zgjedhje nuk është aq e rëndësishme sa procesi zgjedhor. Zgjedhja e ekipit të preferuar nuk ndikon në progresin e shtetit. Kurse, zgjedhja e përfaqësuesve sigurisht që ndikon. Për ta kuptuar me shumë vlerën e votës, lexojeni se çfarë kanë thënë qytetarët.



Gazetarët e artikullit të cilët realizuan intervistën

Nëse ne marrim pjesë në zgjedhje, atëherë kemi të drejtë të kërkojmë përgjegjësi nga përfaqësuesit



Halime Berbatovci, qytetare e intervistuar nga ne

Nëse duam të shohim ndryshimin, atëherë duhet të votojmë të gjithë



Vigan Behluli, qytetari i tretë që intervistuum

Vota është e drejtë dhe këtë të drejtë duhet shfrytëzuar



Qytetari Vesel Krasniqi, duke iu përgjigjur pyetjes tonë

KUVENDI, SHTËPIA E POPULLIT

GETOAR (12), OLT (12), ERBLINA (11), AULONA (11), ARTOR (11), ALTIN (12)



Objekti i Kuvendit të Republikës së Kosovës


Mandati i deputetëve, varet prej qytetarëve

Demokracia është mënyrë e udhëheqjes së shtetit. Qytetarët në demokraci mund ta ngrisin zërin dhe t'i kërkojnë të drejtat e tyre pa asnjë dallim. Vendi se ku dëgjohet zëri i qytetarëve është Kuvendi i Republikës së Kosovës. Por, a e dini se si ndodh kjo? Ne si qytetarë, meqenëse jetojmë në një shtet demokratik siç është Kosova, kemi shumë të drejta të pamohueshme. Ndër to është e drejta e votës. Çdo qytetar, i cili ka arritur moshën 18 vjeçare, ka të drejtën të votojë për personat të cilët mendon se do të jenë përfaqësues të mirë. Këta përfaqësues ne i quajmë deputetë dhe gjithsej janë 120. Nga 120 vende në Kuvendin e Kosovës, 20 janë të garantuara për komunitetet jo shumicë. Kuvendi i Kosovës e ka funksionin legjislativ, ku deputetët bëjnë miratimin apo mos miratimin e ligjeve, propozimin e projektligjeve si dhe shfuqizimin ligjeve.

Marrim shembull, nëse në Kuvendin e Kosovës do të ishte propozuar një projektligj, që ka të bëjë me sigurimin e ushqimit të shëndetshëm pa pagesë për nxënësit e të gjitha shkollave të Kosovës, që nga klasa e I e deri tek ajo e IX. Kjo do të ishte një mundësi e mirë për të gjithë ne, sepse çdo fëmijë ka të drejtën e ushqimit. Funksion tjetër është ai përfaqësues, ku deputetët me mbështetjen e qytetarëve dhe me votat e tyre, marrin titullin e deputetit apo të përfaqësuesit të popullit. Funksioni kontrollues është gjithashtu një funksion shumë i rëndësishëm, që ka të bëjë me kontrollimin e punës të cilën e bën Qeveria. Pikërisht, deputetët janë ata të cilët e zgjedhin kryesuesin e këtij institucioni, pra Kryeministrin. Ne qytetarët, duhet të vetëdijësohemi dhe të kuptojmë rëndësinë tonë në shtetin tonë. Po të mos ishte populli për të votuar, nuk do të ishin as deputetët ata që e udhëheqin shtetin.



Sot qytetarë aktiv, e nesër deputetë



Salla e seancave plenare në Kuvend



Kushtrim Kelmendi, njëri nga qytetarët që intervistuum.
Sipas tij, vota është e drejtë e secilit



Ebrlina, sikurse të gjithë shokët e shoqet e klasës së saj,
është e lumur që ishte pjesë e „Demos-ti“



Me 11 qershor, vota e secilit do të luaj rol në vendin tonë.
Prandaj, votoni me kujdes



Kushtetuta është shumë e dashur për ne. Falë ligjeve që i kemi ne kemi jetë më të mirë



Deputetët e së ardhmes



Puna gjatë shkruarjes së artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Ali Hadri“
Klasa:VI-1
Vendi: Mirash, Ferizaj